

**SOME REMARKS ON THE CHILDREN'S ADAPTION OF O.GRILLO'S
„HISTORI E SKENDËRBEUT“
DISA VËREJTJE PËR PËRSHTATJEN E O.GRILLOS „HISTORI E
SKENDËRBEUT“**

Nikoleta KALLDERMXHI¹

¹ *Academy of Albanological Studies, Tirana*

^{*} *Corresponding author e-mail: nikoleay@yahoo.com*

Abstract

The best way for children to learn is through adult models. If in the world of fashion the model is the small size of the mother's clothing, in literature is the most beautiful adaptation. Art and language technique that ensure the continuity of thoughts and events in adaptation are the subject of this paper. Comparing it with N. Frashwri report, we have noted the way of interpreting the lexical data and the internal connection of this semantic categories that ensure these connections as a good opportunity to show the values of the Albanian cultural heritage through the language. O Grillo's scholarly narrative enables us to provide explanations that gives paraphrases of notions or summary of the time sequences of fragments the breakdown of popular syntactic structures as an important part of maintaining the grammar plan we have served more than 15 units words stable and phraseological phrases together with their illustration for enthusiastic albanian readers.

The explanations are made in conjunction with their semantics in the work of N. Frashwri "Histori e Skendërbeut" bringing them in two contemporary context, in accordance with the psychological features of the age and ethical values recognizing the didactic and ethical values of N. Frashwri. We say that the existing pictures is added to the civic and ethical competence of this age group. The methodology followed is that of analysing the text to point out the ways of paraphrasing, hyperonymy, hyponymy. The paper argues the need for writing and learning Albanian with levels, thus serving the little ones, but also further.

Keywords: *paraphrasing, linguistics unit, hyponymy, hyperonymy, linguistics level*

Përmbledhje

Mënyra më e mirë për të mësuar fëmijët janë modelet e të rriturve. Nëse në botën e modës modeli është masa e vogël e veshjes së nënës, në letërsi është përshatja më e bukur. Arti dhe teknikat gjuhësore që sigurojnë vazhdimësinë e mendimeve dhe të ngjarjeve në përshtatje janë objekt i këtij mëtimi. Duke e krahasuar me kallëzimin e N. Frashërit kemi vëmë në dukje mënyrën e interpretimit të dhënave leksikore dhe lidhjeve të brendshme të kategorive semantike që sigurojnë këto lidhje, si një mundësi e mirë për të treguar edhe vlerat e trashëgimisë kulturore shqiptare nëpërmjet gjuhës. Rrëfimi dituror i O. Grillos na mundëson shpjegime që japin parafrazime të nocioneve apo përmbledhjen e sekuencave kohore të fragmenteve, zëbrthimit të strukturave sintaksore popullore.

Si pjesë e rëndësishme e ruajtjes së planit gramatikor kemi servirë më tepër se 15 njësi (fjalë, togfjalësha të qëndrueshëm dhe frazeologjikë) bashkë me ilustrimet e tyre për lexuesit entuziastë të shqipes. Shpjegimet janë bërë në bashkëvajtje edhe me semantikën e tyre të vepra e N. Frashërit "Histori e Skendërbeut", duke i sjellë në një kontekst bashkëkohor, në përputhje me veçori psikologjike të moshës dhe vlerat etike. Duke njohur vlerat didaktike dhe etike të N. Frashërit themi se tabloja ekzistuese i shtohet edhe kompetencës qytetare e etike të kësaj grupmoshe. Metodologjia e ndjekur është ajo e qëmtimit të tekstit për të vënë në dukje mënyrat e parafrazimit, hiperoniminë, hiponiminë. Punimi argumenton nevojën e shkrimit dhe mësimin të shqipes me nivele, duke i shërbyer kështu të vegjëleve, por edhe më tej.

Fjalë kyçe: parafrazim, njësi gjuhësore, hiponimi, hiperonimi, nivel gjuhësor.

1. Hyrje

Shkrimtarët duke qenë mjeshtërit më të mëdhenj të gjuhës, pesha e fjalë së tyre është e rëndësishme për kulturën ligjërimore të një populli, veçanërisht për të vegjël e të rinj. Sipas prof. Gj. Shkurtaj: “Fjala e poetëve , prozatorëve dhe dramaturgëve tanë më të mirë ngulitet thellë në zemrat e njerëzve, i pasuron dhe i fisnikëron ata dhe ua shton dashurinë për gjuhën amtare”.(Kahe dhe dukuri të kulturës shqipe, fq. 164). Si e tillë aftësitë leksikore dhe mundësitë e mëdha etiko-estetike të gjuhës sonë duhen vënë jo vetëm në dukje, por edhe të sillen si nivel i veçantë i gjuhës apo si origjinalitet i gjuhës feminare.

Mënyra më e mirë për të mësuar fëmijët janë modelet e të rriturve. Nëse në botën e modës, modeli është masa më e vogël e nënës, në letërsi natyrisht do të ishte përshtatja më e bukur. Rrëfimi ditur i N. Frashërit me shpjegimet për vlerën e atdheut, fatit, njeriut shqiptar i ka dhënë mundësi përshtatjes së O. Grillos të zbulojë më tepër se një vlerë siç është ajo e lirisë dhe a atdhedashurisë, në funksion të së cilës është përshtatja. Interpretimi i të dhënave leksikore, lidhjet e brendshme të kategorive semantike e vënë në dukje këtë trashëgimi kulturore, shpirtërore dhe zbulojnë vlera etiko-estetike nëpërmjet gjuhës.

“*Histori e Skëndërbeut*” e përshtatur nga O. Grillos jep një larmi gjuhësore të shqipes dhe një kontribut në lëvizimin e shkrimit shqip për fëmijë, zbulon vlera të reja në trashëgiminë e pakorrë të Homerit shqiptar, pasuron frazeologjinë e sinoniminë me njësi të reja. Ky mëtim i shkurtër jep një kontribut modest në mënyrën si janë bërë perifrazimet e nocioneve apo përmbledhjen e sekuencave kohore të fragmenteve të fragmenteve me qëllimin që si frazeologjia, ashtu edhe sinonimia të kenë vlera praktike në jetën akademike e aventurore të fëmijës.

Duke vërejtur se kjo vepër është vlerësuar te “Historia e letërsisë për fëmijë e të rinj” të A. Bishqemit: “Gjuha e përshtatjes së Grillos sipas këtij autori, është ajo e poetit , por me tingëllimin e shqipes së sotme letrare. Grillo ka shfrytëzuar leksikun e Naimit, frazën e tij karakteristike, ngjyrimin stilistikor dhe gjuha e re e prozës ka dalë e këndshme, e shkathët dhe e pasur; vlerësuar edhe nga Instituti Ndërkombëtar në Mynih të Gjermanisë si dhe nga studiuesja Emine Shabani, e cila ruan të njëjtin këndvështrim me atë të Bishqemit.(Filoogjia, vol.5. No. 8,fq.47); nga Prof. Bedri Dedja qw duke folur për rikrijimin thotë se O. Grillo çeli një rrugë të re në letërsinë për fëmijë,bashkohemi edhe ne se ai është nismëtar i saj dhe është vënë në garë me kolosë botërore në këtë fushë. Por përveç vlerësimeve duam të tërheqim vëmendjen te përmirësimet e mundshme të saj, që kanë të bëjë me përshtatshërinë dhe qartësinë që i serviret moshës.

Lexuesi i vogël që kërkon ta bëjë këtë vepër pronë të vetën shpirtërore në një kohë kur ata janë në formim e sipër, ndaj kërkon më tepër shpjegime me fjalët kyçe e veçanërisht për frazeologjinë e cila është sa interesante, aq e destinuar për t’u mbajtur mend për një kohë të gjatë. Kërkesa bashkëkohore për përditësim të fjalëve, idiomave si modelet e gjuhëve më të përparuara, bën që veprat e mira të jenë të shteruara e në sinkroni me kërkesat moshore. Teksa frazeologjia është deshifruesi i besimeve, kulturave, konventave shoqërore; të perceptuarit e mendimeve dhe të gjuhës , sinonimia zbulon diçka tjetër. Ajo i lë perpespektivë përmbledhjeve me nivele për mësimin e shqipes në shkollë ose nga të huajt.. Thjeshtësia tërheq vëmendje e mbahet mend lehtë. Ajo ka realizuar jo vetëm shije gjuhësore, por edhe oreks për të njohur gjuhën amtare.

2. Modifikimi i elementeve naarrative

Fëmijët sikurse dhe të rriturit presin t’i kenë historitë e tyre nga shkolla, shtëpia, me miqtë e familjarët ose të treguara prej këtyre të fundit. Duke qenë se përvoja sikurse dhe fjalori i tyre është i limituar, përshtatjet vijnë në format e rrëfimeve për fëmijërinë apo të kaluarës.

Dhe në këtë rast të krijohet përshtypja se bashkë me Skëndërbeun lexuesi merr pjesë në të gjitha betejat e tij me pashallarë e sulltanë. Gjithçka në sytë e fëmijës paraqitet si e re dhe në përputhje me motivet e përshtatjes për ta bërë të pavdekshme veprën e heroit kombëtar, përshtatja i siguron mbështetje emocionale për rrethana apo mendime problematike a konfuze në jetë. Siç e përmendëm që në fillim përshtatjet sipas modeleve bëhen për të kuptuar më mirë jetën, zakonet, mënyrën e jetësës apo edhe religjionin. Për t'i sjellë ato nuk do të mjaftonte zvogëlimi në madhësi, por edhe në esencë. Ndaj dhe **metodologjia** e ndjekur është ajo e qëmtimit të tekstit për tëvënë në dukje mënyrat e parafrazimit, hiponimia, hiperonimia, sinonimia dhe strukturat sintaksore popullore. Parafrazimi i një teksti poetik në një tekst në prozë ka kërkuar si zbatime gjuhësore ashtu edhe letrare, siç është futja e perosnazhit në vend të fjalëve të autorit.

Për të treguar shërbesën e përshtatjes së tij si dhe prespektivën e veprave të tjera të ngjashme, mjaftojmë të citojmë vetë O. Grillon i cili pohon se vepra të tilla lexohen me endje jo vetëm nga fëmijët, por edhe nga të rriturit e shtresave të gjera, që e kanë të vështirë t'i lexojnë veprat në origjinal. Veç këtyre sot rikrijohen edhe vepra madhore sipas klasave që ndjekin nxënësit: për klasën e parë me një fjalor prej 200 fjalësh, për të tretën me pesëqind dhe kështu me rradhë. Madje rikrijohen sipas moshës e klasës edhe kryevepra të letërsisë për fëmijë si "Pinoku" etj¹⁵². Ndaj nëpërmjet fjalësave në fund të librit duhet të evidentohet kjo pasuri e shqipes dhe qëndrim metodologjik i mësimin të saj, parasysh edhe nivelin e ulët të mësimin të frazeologjisë në shkollë.

3.Fjalësi i shoqëruar me togëfjalësha të lirë dhe frazologjikë

Hape parajsësn	liri, begati, mirëqenie, vend i bukur
Gudulis	u gudulis nga fjalët
Shpresë	shpresë e shqipërisë
Mirësija	mbretëron mirësija
T'i sjellësh vërdallë	t'i sjellësh rrotull, t'i mbash me fjalë, t'i lodhësh
Ia hëngri kokën	t'i bënin varrin
Nuk iu tremb syri	trim, ka shkelur mbi vdekjen
Më shkulën zemrën	iu bë zemra dysh, u pikëllua
Më prenë krahët	i shkëktuan vuajtje të mëdha
Me kulaç e me kërbac herë me të mirë e herë me premtime	
Sa për sy e faqe	sa për t'u dukur, sa për të kaluar rradhën, sa për të thënë, jo me çiltërsi,
Vath në vesh	nuk e harroj, e ngulit mirë në kokë
Mos e luaj bishtin	mos e tradhëto, mos luanin nga fjala
Jam ngopur gjer në grykë	jam mërziur
Si në pëllëmbë të dorës	shihet shumë mirë

¹⁵² Odhise K.Grillo, Historia e Skëndërbeut për fëmijë, Shtëpia botuese Mësonjtorja, nëntor, 1999

e- "Murati mbret i Turqisë që se di c është bir e bijë, s'ka pjesën e njerëzisë, dashuri s'ka në fëmijë/ay do të mbretërojë që të bëjë ligësitë " (N. Frashëri, fq.31) "është prishës e shkretënjës , shpirtërrët e zemërkëllirë"

Egërsirë. Fig< prishës, shkretënjës, vrasës, mundonjës shpjegimi i fjalës bëhet nëpërmjet hiperonimisë

f- "Se Arbëria nga ju ka shpresë dhe pret t'i sillni shumë të mira.Po të jeni të jeni i bashkuar, s'ju ha dot asnjë egërsirë. (O.Grillo,fq 17)

"Shpresë e gjithë Shqipërisë ish atje te fron i mbretit (H. e Skëndërbeut, fq. 207)

Shpjegimi i fjalës *shpresë* sipas kontekstit do të ishte *gjërat e mira,dhe* nga ana tjetër qëndrimi i Naimit për *shpresën* për përmbushjen e dëshirave ishte te froni mbretëror. Është një zgjedhje metonimike e poetit Naimit që i siguron dhe ardhmërinë e shpresave të shqiptarëve.

g- "Para se të vendosim duhet të pyesim zonjën e shtëpisë, mëmën e fëmijëve..."(O.Grillo, fq.15)

Mbretëresha ishte ngritur/ dhe ish veshur e ish ngjeshur/ posi nuse përsëritur, punonte llërëpërveshur/ishte shumë punëtore edhe e urt' e e zgjuar/ për cdo punë i vinte ndore/ ish e mirë dhe e lëvduar/ pesë vasha bukuroshe/edhe shërbëtore tetë/ t'i shihje yje thoshe/ dhe ajo hëna vetë/ vashat si pëllumbesha rrotull e kishin rrethuar/ dhe në mest mbretëresha m'u si lule e lulëzuar/ po me duar prej argjendi/ po punonin e mësonin, s'hiqeshin nga avlemendi/e si thëllëza shikonin/ Mbretëresha edhe vetë / kishte zënë e punonte/ pune e saj ish pa të metë nga të tjerat ndërronte. (N.Frashëri, fq.34). tabloja krijon një varg sinonimik të konotacioneve të tipareve shoqëruese.

Zonjë e shtëpisë< mbretëreshë shpjegim në bazë hiperoniminë në shpjegimet që do të vijonin do të renditeshin një varg epitetesh si e patëmetë, punëtore, e urtë, e zgjuar, e mirë, e lëvduar, lule e lulëzuar, duarargjendë të cilat vlejné për të dyja fjalët me të cilën autori ka perifrazuar , me një lidhje hiperonimike. Ndërtime tw tilla dhe me një fjalë jopolisemantike e ndihmon perceptimin e moshës, por edhe shpjegimet që mund t'i siguron një fjalës në fund të librit do të ishin po aq të vlefshme e praktike.

."Ata duhet tq mesojnë/ të behen të vërtetë/ të lëftojnë e të gjykojnë/pas nevojës që të jetë "(N. Frashëri, vargu 405)

"...të mësojnë të vërtetën e të bien për Arbërinë" (O.Grillo, fq.12)

Mund të sihin perifrazuar edhe më mirë për të prurë natyrën paqedashëse të shqiptarit.

k- . "Të mblidhet këshilli i luftës dhe pleqësia! (O.Grillo, fq. 10)

"të mëdhenj edhe të parë/edhe gjithë pleqësia/c'qenë cel e luftëtarë e shumë nga vegjëlja, në mbledhje të gjithë rrodhë, pas mënyrës së lirisë,/bashkë me mrenë u mblodhn si të afërt e shtëpisë/ gjithë burrë të vërtetë

Autori ka përmbledhur disa vargje të Naimit duke bërë që fjala këshilli i luftës të jetë një gdhendje e asaj që thotë Naimi. Kështu dihet kush mblidhet dhe në cilën mënyrë. Kategoritë etike si puna, familja janë më pak të rëndësishme për idenë e Grillos se liria dhe atdheu. Por të bërë përshtypje të mëtejshme imazhet naimiane mund të serviren si shpjegime të fjalëve.

6. Frazologjitë që bëjnë sintetizimin e praragrafëve.

Frazeologjitë e shumta të përdorura, që duhet t'i shtohen veprës si shpjegime, megjithëse pak të vështira i japin dorë mbresës artistike. Rrëfimi kështu i ngjan atij të gjyshit apo të gjyshes me ndalesa e me pyetjet e vazhdueshme të fëmijës: Po kjo fjalë cfarë domethënë/" . Nga ana tjetër frazeologjinë që në shumicën e rasteve e kemi zbërthyer me fjalë të tjera, i bën lexuesit i lë një përshtypje të vecantë, nëpërmjet lidhjes në njëfarë mënyre të prishur të fjalëve, por megjithatë lehtësisht të kapshme të shpjeguara.duke krahasur veprën origjinale me përshtatjen po japim shembullin e parë. "mos bjer në luftë, vëlla uran, po *mundohu t'i sjellësh vërdallë*, se kemi zjarre në shumë krahë"(o. Grillo, fq. 67).

Ndërsa N. Frashëri thotë: “të zimi malë e t’i bëni të mënojnë...”. duke e krahasuar me frazeologjinë e gjuhës shqipe (fq.251) po më mban me fjalë, arrijmë të perfrazojmë: beji të mendohen, për të shmangur luftën

Pra frazeologjia me marrëdhënie rrethore të *sjellësh vërdallë - lodhi*. nëpërmjet këtij përdorimi Grillo pasuron me shpjegon frazeologjinë e gjuhës shqipe dhe i jep një çelës në veprimtarinë shoqërore .

a .“kërkoni liri e të drejta, kërkoni të përmbysnin, *kërkoni t’i hanin kokën*”(O.grillo, fq 73) =donin t’i bënin të vdiste; nuk i trembej syri=ka shkelur kushedi sa herë mbi vdekjen=trim

b “Cila zemër i pa e nuk u bë më dysh...”(O. Grillo,fq.18).”më prenë krahët”, “më nxorrën sytë”, “më shkullën zemrën” intesifikojnë veprimin e vuajtjes deri në shkallën maksimale.

Mundet që fëmija t’i përafrohet kuptimit të këtyre shprehjeve frazeologjike, duke parë edhe ilustrimin në krah të librit. Vetë shprehjet frazeologjike e kanë të nevojshëm shpjegimin.

c .”...duke përcarë e duke sunduar, andej duke blerë me para, me një anë, duke premtuar me anën tjetër, *duke përdorur kulacin dhe kërbacin* i nënshtronin të gjithë “(O. Grillo, fq 73). Në bazë të FGJSSH, Toena, fq 626 *do të thotë: herë me të mirë e me premtime, herë me kërcënime e me dhunë* .Konteksti si burim i kuptimit shpesh është këshilluesi më i mirë dhe në rastin tonë sinonimon *sundim me kërcënim e dhunë*. Kjo shprehje me marrëdhënie këpujore, ku fjalët ruajnë kuptimin e tyre konotativ në lidhje, sjellin sikurse të tjerat atmosferën e kohës në të cilat zhvillohen ngjarjet.

d.”Pa i dërguan dhurata, flori me qese e barrë me të gjitha të mirat, aq sa s’kishte vend ku t’i vinin. Skëndërbeu *sa për sy e faqe*, i foli po ama *vath në vesh* ua kishte atë që bënë, dhe i ruante *të mos e luanin prapë bishtin* (O.Grillo, fq.72).

Sa për sy e faqe - sa për formë;sa për t’u dukur që u bë diçka ose se është në rregull, sa për të kaluar rradhën, sa për të thënë (Frazeologjia e gjuhës shqipe, fq.213)-jo me çiltërsi, jo me gjithë zemër (FGJSSH, fq 1220).

Kuptimi i shprehjes frazeologjike *sa për sy e faqe* që ka strukturë fjalie do të thotë *sa të dukej se nuk e mbante hidhërimin*. Ndërsa *vath në vesh-nuk harroj* (Frazeologjia e gjuhës shqipe,fq.306);*mos e luaj bishtin-1) mos tradhto 2)mos luaj nga fjala; mbaje fjalën*.

Pra perfrazimi do të ishte: i foli sa të dukej se nuk e mbante hidhërimin, por nuk harroj dhe i ruante mos e tradhëtonin ose në mënyrë proverbiale: *fal, por mos harro*.

Mos e luaj bishtin duke shërbyer edhe si togfjalësh i lirë mund të ngatërrohet. Ndaj e mira është që idiomat të mësohen të mësohen në shkollë dhe do të ishte meritë vendosja e tyre në tekstet mësimore pasi në këtë cikël ato janë të rralla. Më së shumti mbizotërojnë togfjalëshat e lirë e të qëndrueshëm e frazeologjia përfitohet nga ligjërimi, aq sa shumë e njohin prindërit.Të përdorshme edhe në ligjërimin bisedor ato e bëjnë ligjërimin të bukur, të figurshëm, bindës. Urtësia popullore, ndjenja e hollë e krijuesit të madh, të mishëruara në këto shprehje të shkurtra, i japin gjuhës një gjallëri e larmi të këndshme.

Duke qenë se edhe frazeologjia është polisemantike mund të jetë pak më e ndërlikuar, por me efekt stilistik të fuqishëm.

d.”*Se jam ngopur gjer në grykë me fjalë* të mira e me premtime. Edhe po nuk më njohu ai për mbret,më njohin trimat e mi [...]”(O.Grillo, fq112). Shprehja frazeologjike me strukturë fjalie ka kuptimin jam mërziur.

Por krahas shpjegimeve mund të shfrytëzohet edhe konteksti për të gjetur kuptimin e frazeologjisë si në rastin:”hëna ndriçonte për bukuri dhe gjithçka dukej *si në pëllëmbë të dorës...*”po ta krahasojmë me kuptimin që i jepet te frazeologjia shqipe *dukej shumë mirë* kuptimi i shprehjes del e ndriçuar. Pra konteksti shërben edhe për shpjegim. Po ashtu te ky autor gjejmë frazeologji të tjera si “sa pare i bën lëkura”, “kthenin thëmbren nga majat”, “fitoi kohë”, “ia bëri benë”,”mizë lisi” etj.

Frazeologjia e cila përbën një thesar mund të vendosen gjatë mësimimit të fragmenteve, për përdorim të përditshëm. Të tilla janë ato që kemi vendosur te fjalësi me togëfjalësia të lirë e frazeologjikë, përveçse përdori kulaçin e kërbacën që sjell frymën e kohës..por mund të sillen përdorimi *herë me fjalë, herë me premtim*. Zhvillimi i aftësive të tyre me gojë e me shkrim është një anë është po aq e rëndësishme sa edhe mbështetja emocionale gjatë rrethanave problematike në jetë. Po kaq dinamike janë edhe fjalët kyçe të përdorur nga ky autor si dhe krahasimet, epitet e hiperbolat në përshtatje me veçoritë moshore. *Edhe një mijë herë po të lindja do të isha ushtar i Skënderbeut ...* mund të ishte titulli i një eseje në mbarim të një bisede letrare për këtë libër.

7. Përfundime

Tema madhore e mbarëkombëtare të letërsisë sonë si Shqipëria (mëmëdheu), Skënderbeu (heroi kombëtar) në përshtatjen e O. Grillos është një arritje jo vetëm e letërsisë për fëmijë, por edhe objekt i veçantë i gjuhëtarit për pasurimin e leksikut të shqipes dhe ndriçimit të marrëdhënieve ndërmjet tekstit e gjuhës. Interpretimi shkencor na favorizoj të nxjerrim fjalët kyçe dhe marrëdhënieve në lidhjet e brendshme semantike të 4 vargjeve sinonimike dhe shpjegime të tyre mbi bazën e hiperonimisë krahasuar me shpjegimet e Naimit dhe të FGJSSH duke e gjallëruar gjuhën dhe përshtatur për fëmijë.

Autori ka vënë në qendër të përshtatjes së tij frazeologjinë që e ka ndihmuar për të parafrazuar paragrafë të tërë, duke i dhënë rrëfimit jo vetëm frymën e kohës, por edhe atë popullore. Mësimi në shkollë i këtyre krijimeve letrare që zhvillohet në përputhje me orën e mësimimit dhe të veprimtarisë në kohën e lirë dhe që janë bazë për zhvillimin e tyre, përmbajnë vlera të mëdha emocionale, edukative e njohëse, pasurojnë dhe gjallërojnë përfytyrimet e tyre, rrisin shkallën e njohjes, si rrjedhojë mësojnë fjalë të reja, i përdorin ato gjithnjë e më shumë e me vend, rrit e botimit të përmbledhjeve me nivele të veprave madhore të letërsisë. Kjo natyrisht kërkon një studim më të thelluar të përshtatjes që kemi në dorë, por edhe veprave të tjera të ngjashme.

Frazeologjia si thesar i trashëgimisë sonë gjuhësore edhe te kjo vepër ka nxitur përfytyrime konkrete duke ngjallur emocionet dhe ndjenjat e duhura. Njëherazi kanë dalë njësi që kanë dalë të mundshme për t'u zotëruar në mënyrë aktive. Mësimi i tyre si pjesë e social-psikologjisë duhet të fillojë që në klasat e CU. Imazhet e ruajtjes së lirisë dhe identitetit kombëtar në 110 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë, frymëzojnë brezat me dashurinë për punën, dijen, lirinë e atdheun. Po të kemi parasysh mekanizmin poetik dhe gjuhësor të të dyja veprave, flasim me siguri dhe i japim edhe një përgjigje peyetjes pse lexojmë e shkruajmë. Shkruajmë me atë që unë e quaj pasion të disiplinuar, duke e ditur se shumë lexues gjatë kësaj kohe merren me qëndrime historike e identitete, e vlera të jetës të të kaluarës krahasuar me të sotmen. Lexues të ndryshëm preferojnë veprimtari familjare të leximit dhe e mira do të ishte dhe e diskutimit për to. Nga ana tjetër ne shkruajmë për t'i ndihmuar studentët të jetojnë më mirë, të bëjnë jetë më të përmbushura e të dhembshura jetët e tyre, e të kujtojnë historinë e paraardhësit e tyre.

Referenca

- A. Bishqemi, Histori e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj, Lindje dhe dy perëndime, 2008.
- .A. Shashaj, Të folurit e fëmijëve të moshës parashkollore dhe puna për zhvillimin e tij, Onufri 1996.
- A.Dhrimo, J. Thomaj, Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe, Botimet EDFA, Tiranë 2007
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Fjalor i shqipes së sotme, Toena, 2002.
- Fjalët e formuara me parashtesa dhe prapashtesa K. Cipo I quan derivate, domethënë të prejardhura. Gramatika shqipe, Tiranë 1949.
- Fjalori i Shqipes së Sotme, Botime Toena, Tiranë, 2002.
- J. Thomaj, Vështrim mbi leksikon e ligjërimit poetik të N. Frashërit, Tiranë, 2008.
- J. Bulo, Gjuha e Naimit: E tashmja dhe e ardhmja e shqipes, Tiranë 1999
- M. Gjevori, Frazologjia e gjuhës shqipe, 1980
- N. Frashëri, Historia e Skëndërbeut, Botimet M&B, Tiranë 2019
- N. Kalldrëmxiu, Zhvillimi psiko-motor dhe rritja e kompetencës leksiko-semantike nga 0-12 vjec, Tiranë 2017
- O. K. Grillo, Historia e Skëndërbeut për fëmijë, Mësonjëtorja, 1999
- R. Vasta, M. Haith, S. Miller, Psikologjia e fëmijës, 1992.
- Rr. Paçarizi, Shqipja standard në parametrat psikolinguistikë, Prishtinë, 2011.
- Sh. Islamaj, Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe, Instituti albanologjik i Prishtinës, 1985.
- T. Plangarica, Aspekte të gjuhësisë së zbatuar, Sejko, 2002.
- T. Plangarica. Aspekte të gjuhësisë së zbatuar. Sejko, 2002.
- T. Plangarica. Cikël leksionesh. Hyrje në studimin e kuptimit. Semantikë dhe pragmatikë. Nga Sandrine Zufferey dhe Jacques Moeschler.
- V. Memisha “Ushtrime për Leksikologji dhe Semasiologji leksikore” , Tiranë 2007.